



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 47

Prishtinë, më 12.07.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, S-1

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Njomza Emini, Xhavit Haliti, Vjosa Osmani, Luljeta Gutaj-Veselaj, Bislim Zogaj, Arben Gashi, Donika Kadaç-Bujupi, Kujtim Paçaku dhe Slobodan Petroviq.

Munguan: Valdete Bajrami dhe Time Kadriaj.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi kryetarja e Komisionit, znj. Njomza Emini.

Në mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-088 për rregullat e komunikacionit rrugor, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 6. Të ndryshme.**

Kryetarja e Komisionit pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i Rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja tha se bazuar në vendimin e seancës plenare të dt. 7 korrik 2016, është vendosur që Projektligjit nr. 05/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 të shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar dhe sot është afati i fundit për shqyrtim.

Lidhur me këtë Projektligj paraqiti opinionin ligjor lidhur me përputhshmërinë me legjislacionin e BE-së.

Pas shqyrtimit dhe verifikimit është konstatuar se ky projektligj nuk rregullohet me legjislacionin e BE-së, por mbetet kompetencë e brendshme e shteteve anëtare, andaj konstatojmë se Projektligji së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Vjosa Osmani theksoi se pasi Ministria e Integrimeve Evropiane na ka njoftuar si Komision se kanë pasur problem rreth buxhetit dhe gjatë leximit të parë e kam ngritur këtë çështje, ku buxheti i marr nga Ministria për Integrim Evropian, përafërsisht 50 mijë € të kthehet, sepse ishte destinuar për të bërë kampanjën e vetëdijesimit për procesin e liberalizimit të vizave, gjë që e kemi kërkuar vazhdimisht si Komision, po e shoh që në amendamenti numër 6 është bërë një ndryshim që pjesërisht është marrë parasysh vërejtja jonë që nuk mjafton për planifikimin e kampanjës, por është një lehtësim sepse një shumë e madhe do të jepet edhe nga donatorët.

Vërejtja tjetër në seancë gjatë leximit të parë ishte edhe mos përfshirja e një ligji të caktuar në buxhetin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, po flas për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë i cili parasheh përveç pensionit të caktuar edhe kujdestarin personal për personat që janë në këtë gjendje, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale tha se kjo do të bëhet mes dy leximeve, por nga amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, nuk po shoh që është përfshirë dhe siç e kam thënë edhe më parë, çështja e të drejtave të njeriut jo vetëm që është pjesë e raportit të progresit, por po ashtu është një ndër kapitujt themelor të Acquis coomunitare dhe që i bie të jetë në mandatin e Komisionit tonë që të shohim që çështjet e tilla të rregulluara me ligj kanë mbetur jashtë ligjit për buxhet.

Prandaj për të gjitha këto arsye nuk do të votoj, por do të abstenoj për buxhetin.

Luljeta Gutaj- Veselaj theksoi se edhe gjatë leximit të parë, e kam ngritur çështjen pse nuk janë përfshirë rekomandimet e dala nga monitorimi i zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e trafikimit të qenieve njerëzore? Ne bashkërisht i kemi nxjerrë rekomandimet që janë votuar në Komision dhe Kuvend, por asnjëra prej tyre nuk është marrë parasysh. Ministrin Hoti dhe ministrin Abrashi e kam pyetur, por asnjëri nuk më ka dhënë përgjigje, por do ta ngrija prapë si shqetësim pse nuk janë përfillur, sepse më është premtuar që me rishikim të buxhetit, sepse 3 rekomandime kanë të bëjnë me rishikim të buxhetit, por të paktën njëra prej tyre të ishte marrë parasysh në rishikim.

Kujtim Paçaku i përkrahu diskutimet e parafolëseve dhe tha në Kuvend po miratohen ligje, por nuk po zbatohen. Pse nuk po zbatohen duhet ta gjejmë shkakun dhe njëjtë ndodh me kuotën për

shumën e mjeteve dedikuar komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas? Në komisionin për të drejtat e komuniteteve e kam ngritur çështjen për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe e njëjta ka ngelur e zbrazët dhe për këtë arsye edhe unë nuk do të votoj, por do të abstenoj.

Xhavit Haliti theksoi se me procedurë ato rekomandime që kanë kaluar në Parlament dhe janë votuar, duhet të kërkohet të përfshihen në ligj, kurse ato që janë diskutuar dhe nuk janë votuar nuk përfshihen, mendoj se duhet drejtuar me shkrim në Kryesi dhe t'i diskutojmë në seancë.

Arben Gashi tha se nuk po e kuptoj ku po lidhen rekomandimet e Komisionit me ligjin e buxhetit dhe nuk e di a kemi kohë ne me bërë amendament në buxhet, saktë dhe konkret duhet me e specifikuar se çka po kërkojmë ne.

Vjosa Osmani tha se rekomandimi i katërt është më konkret sepse e kemi numrin e strehimoreve dhe me parapaj një shumë simbolike për secilën prej tyre dhe me i përfshirë në buxhet.

Luljeta Gutaj -Veselaj shtoi se shumica e strehimoreve janë në falimentim e sipër dhe kam pasur shumë kërkesa prej përfaqësuesve të strehimoreve që i kemi vizituar se janë gati në falimentim, njëra prej tyre është në Prishtinë që merret me mbrojtjen e fëmijëve dhe grave nga trafikimi dhe dhuna. Ne me grupin punues i kemi vizituar dhe i kemi parë se në çfarë gjendje financiare janë.

Kujtim Paçaku vlerëson që nëse shkohet me amendament, të mos kërkohet shumë simbolike për strehimoret, por të jetë një shumë e qëndrueshme sepse vetëm atëherë do ta ketë efektin më të madh.

Donika Kadaj- Bujupi informoi se vitin e kaluar kishte qenë anëtare e Komisionit për Buxhet dhe tha se kishte përgatitur amendamentin i cili ishte miratuar për 5 strehimoret, përafërsisht me shumën prej 200 mijë € nëpërmes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe është themeluar për herë të parë kodi i veçantë buxhetor, kështu që tha, planifikojeni me buxhet dhe me ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, sepse vitin e kaluar ka qenë një kod i ri në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale i cili është quajtur për strehimoret dhe ka qenë hera e parë që e kemi pasur një kod të veçantë.

Atëherë është më lehtë me i bartur mjetet për strehimore në kodin ekzistues nëpër mes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Kryetarja pas votimit konstatoi se me një votë kundër dhe 2 abstenime Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 05/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, nuk rregullohen në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Rekomandojmë Komisionit Funkcional që të bëjë ndarjen e mjeteve financiare në Projektligjin nr. 05/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, sa i përket blerjes së shërbimeve për mbrojtjen e viktimave kundër trafikimit dhe dhunës, si dhe krijimi i një linje të veçantë buxhetore dhe të qëndrueshme që ka të bëjë vetëm me mbrojtjen sociale të fëmijëve duke përfshirë edhe financimin e strehimoreve për fëmijë.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja njoftoj se në të njëjtën seancë është vendosur që edhe ky Projektligj të procedohet me procedurë të përshpejtuar. Lidhur me këtë Projektligj paraqiti opinionin ligjor, pas shqyrtimit dhe verifikimit është konstatuar se ky projektligj nuk rregullohet me legjislacionin e BE-së, por janë kompetencë e brendshme e shteteve anëtare. Prandaj konstatojmë se Projektligji së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Lidhur me këtë Projektligj e hapi diskutimin.

Donika Kadaj-Bujupi, nuk kishte vërejte në Projektligj, por tha se kishte konstatuar se është bërë rutinë, që çdo herë kur ka ligje të rëndësishme të veçantë, sidomos ato që kanë të bëjnë me buxhet dhe financa, kalohen me procedurë të përshpejtuar. Prandaj cili është qëllimi, a me fshehur diçka apo cila është ideja?

Në fillim të çdo viti ekziston një planifikim i ligjeve dhe parashihet me u proceduar me procedura të rregullta, diçka që parashihet me ndodhur një vit më herët, në vazhdimësi po silltet brenda ditës dhe në parim vota ime do të jetë kundër, jo në përmbajtjen e projektligjit, por për shkak të procedurave të jashtëzakonshme që po aplikohen vit pas viti, nuk mendoj se gjithçka që ka të bëjë me buxhetin, gjithnjë duhet me pasur shmangie nga rregullorja, por ishte dashtë me ndodh e kundërta, është dashtë me ju dhënë më tepër kohë deputetëve me e shqyrtuar projektligjin.

Pas votimit **kryetarja** konstatoj se Komisioni me një votë kundër nxori këtë;

Rekomandim

Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal, me amendamentet e Komisionit Funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj si i tillë mund të rekomandohet për miratim me procedurë të rregullt në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinionin lidhur me përputhshmërinë e këtij projektligji me legjislacionin e BE-së, pas shqyrtimit dhe vlerësimit është konstatuar se ky projektligj nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së. Prandaj si i tillë mund të rekomandohet për miratim me procedurë të rregullt në Kuvend.

Lidhur me këtë projektligj e hapi debatin.

Pas votimit kryetarja konstatoi se Komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës, Shqyrtimi i Projektligjit për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së. Prandaj si i tillë mund të rekomandohet për miratim me procedurë të rregullt në Kuvend.

5.Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-088 për rregullat e komunikacionit rrugor, me amendamentet e Komisionit FunkSIONal nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me përputhshmërinë e këtij projektligji me legjislacionin e BE-së, pas shqyrtimit është konstatuar se ky projektligj nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së. Prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Lidhur me këtë projektligj hapi debatin.

Pas votimit kryetarja konstaton se Komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 05/L-088 për rregullat e komunikacionit rrugor, me amendamentet e Komisionit FunkSIONal nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

6. Të ndryshme

Kryetarja njoftoi se GIZ-i do ta organizojë një vizitë studimore në Berlin dhe Bruksel prej dt. 26-30 shtator, kurse sa i përket vizitës në Kroaci tha se do të realizohet pas zgjedhjeve që do të mbahen në këtë vend.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Njomza Emini